



VENDIM

Nr. 100, Datë 17.06.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVR PER MIRATIMIN E KONTRATËS
TIP PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDERMJET
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT TE SHERBIMIT
UNIVERSAL**

Në mbështetje të nenit 16 19 gërma “a” dhe 98 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 5 dhe 14 te VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 “Per miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe FURNIZUESIT TE SHERBIMIT UNIVERSAL, OSHEE SH.A.,

Konstatoi :

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin Nr. 244 date 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”
- Ne nenin 14 te VKM Nr. 244 date 30.03.2016, parashikohet se: *Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri ne miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, ne përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Enti Rregullator i Energjisë brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.*

Per gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërise së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE sh.a.”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a dhe KESH sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI